

VENDIM
Nr. 584, datë 28.8.2019

PËR PËRBËRJEN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT
KOMBËTAR TË SHËNDETËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 6/1, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Këshillit Kombëtar të Shëndetësisë, i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë dhe ka në përbërje, si më poshtë vijon:

- a) Një përfaqësues nga Urdhri i Farmacistit;
- b) Një përfaqësues nga Urdhri i Mjekut;
- c) Një përfaqësues nga Urdhri i Infermierit;
- ç) Një përfaqësues nga Urdhri i Stomatologut;
- d) Dy personalitete të shquara në fushën e shëndetësisë, të përzgjedhur nga ministri përgjegjës për shëndetësinë;
- dh) Një përfaqësues nga Shoqata e Bashkive;
- e) Një përfaqësues nga Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë;
- ë) Një përfaqësues nga Universiteti i Mjekësisë Tiranë;
- f) Dy përfaqësues të shërbimit shëndetësor jopublik, të përzgjedhur nga ministri përgjegjës për shëndetësinë;
- g) Një përfaqësues nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

2. Institucionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit, të përcjellin pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë emrat e përfaqësuesve të tyre.

3. Këshilli Kombëtar i Shëndetësisë jep mendime për:

- a) hartimin e strategjive dhe të programeve kombëtare në fushën e shëndetësisë;
- b) përcaktimin e politikave prioritare shëndetësore;
- c) përmirësime legjislative që ndikojnë në zhvillimin e politikave shëndetësore dhe përafrimin e tyre me ato evropiane;
- ç) çështje të tjera të politikave shëndetësore me kërkesën e ministrit.

4. Pranë Këshillit ngrihet dhe funksionon edhe sekretariati, i cili përbëhet nga tre anëtarë, të cilët janë pjesë e administratës së ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

5. Këshilli mbledhet me kërkesë të kryetarit, jo më pak se tre herë në vit. Një mbledhje e Këshillit zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve të tij.

6. Mbledhja e Këshillit dhe rendi i ditës u njoftohen anëtarëve të Këshillit nga sekretariati, të paktën pesë ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi për mbledhje duhet të përmbajë datën, orën, vendin e zhvillimit të mbledhjes, rendin e ditës dhe materialet mbështetëse, të cilat u dërgohen anëtarëve të Këshillit, në formë të shkruar dhe elektronike. Në çdo mbledhje të Këshillit mbahet procesverbali që pasqyron të gjitha diskutimet gjatë mbledhjes.

7. Këshilli, sipas rastit, kërkon për dhënie mendimi, ekspertë të ndryshëm të fushës, të cilët përzgjidhen me shumicë të votave të anëtarëve të Këshillit.

8. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama